

**DEKLARATË PËR PRANIMIN E DEKLARATËS SË MISIONIT TË
PËRBASHKËT
TË PUNONJËSVE NË SEKTORIN PUBLIK**

Misioni ynë

Ne të punësuarit në sektorin publik punojmë me qeverinë e zgjedhur në zbatimin e vizionit për një Republikë të Maqedonisë të begatë, të pavarur, sovranë dhe të sigurt.

Ne kontribuojmë në ruajtjen e drejtësisë dhe barazisë, të udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë, ekspertizës, kompetencës, orientimit të shërbimit, etikës profesionale, paanshmërisë, objektivitetit, transparencës, konfidencialitetit, përgjegjësisë dhe funksionimit ekonomik.

Qëllimi ynë

Të ndërtojmë një shoqëri të përgjegjshme dhe të krijojmë kushtet më të mira të mundshme për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor, social dhe ekonomik.

Për të promovuar kohezionin dhe harmoninë në shoqëri - respektin reciprok, barazinë dhe shqetësimin për njerëzit dhe shoqërinë në tërësi.

Klientët tanë

Ne ofrojmë shërbime cilësore, në kohë dhe efikase për qytetarët dhe subjektet e tjera. Ne i trajtojmë ata me ndershmëri, mirësi, dinjitet, me respektin dhe mirëkuptimin e duhur, duke siguruar një marrëdhënie të drejtë.

Ne bëjmë gjithçka për të ndihmuar klientët tanë në realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre, duke u kujdesur për interesin publik.

Kolegët tanë

Ne i respektojmë kolegët dhe bashkëpunëtorët tanë. Ne punojmë në zhvillimin e potencialit të përbashkët përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, i cili përmirëson njohuritë, kompetencat dhe kapacitetet personale.

Ne promovojmë marrëdhënie të mira ndërpersonale, punojmë si ekip, pranojmë diversitetin mbi çdo bazë.

Ne inkurajojmë bashkëpunimin dhe zhvillimin profesional përmes shkëmbimit të ndërsjellë të përvojës dhe të mësuarit.

Besimet tona

Ne ndërtojmë besim në institucionet e sistemit duke u përkushtuar plotësisht në projektet tona dhe duke ofruar shërbime superiore për klientët tanë.

Ndryshimet i pranojmë si sfida, duke besuar se ato çojnë në realizimin e synimeve zhvillimore të shoqërisë.

Me sjelljen dhe punën tonë kontribuojmë në krijimin e institucioneve që përpiqen për përsosmëri.

Duke mësuar nga gabimet tona dhe veprimet e të tjerëve, ne vazhdimisht përmirësojmë punën tonë.

Të udhëhequr nga drejtuesit tanë dhe të hapur ndaj ideve dhe arritjeve të reja në operacione, ne hapim rrugën drejt progresit të qëndrueshëm dhe një shoqërie të begatë.

__ . __ viti ____

**Emri dhe mbiemri i
Nëpunësit administrativ**
